

# R A P O R T

Mbi “ Takimin e Shoqates Rajonale Te Pyjeve dhe Kullotave Komunale Qarku Elbasan “

Vendi : Salla e Konferencave ne Hotel International Skampa Elbasan .

Data dhe ora : 24/10/2008 ora 10.00.

Tema : “ *Trasferimi i Pasurise Pyjore tek komuniteti Fuqizon Fermeret e Varfer* “

Qellimi i Takimit : **Evidentimi i probelemeve te dala gjate Trasferimit te pyjeve dhe Kullotave ne njesite e qeversijes vendore .**

Pjesmarres te takimit : *Bordi i Shoqates Rajonale te Pyjeve dhe Kullotave Komunale Qarku Elbasan ( SHRPKK QE ), Kryetare te SHPPKK-ve nga i gjitha Qarku , Kryetari Keshillit te Qarkut Elbasan Perfaqesues nga MMPAU , perfaqesues Nga Drejtorite e Sherbimit Pyjore ne kater rrethet e Qarkut , Ambientalist , Specialiste Pyjesh , perfaqesues nga SNV -Tirane -Korce ,perfaqesues nga federatat e Pyjeve ne Qarqet Tirane ,Diber , Korce ,Kukes gazetare, etj.*

***Mbeshtetese e Takimit Rajonal : Organizata Hollandeze Per Zhvillim SNV - KORCE.***

Diten e Premte me date 24.10.2008 ora 10 .00 ne Sallen e Konferacave te Hotel International Skampa SHRPKK QE ne bahkepunim me Keshillin er Qarkut Elbasan dhe nen mbeshtetjen e Organizates Hollandez Per Zhvillim SNV organizuan nje takim me teme Trasferim i i pasurise Pyjore tek komuniteti fuqizon fermeret e



varfer .

Ne kete takim moren pjese Kryetari i Keshillit Qarkut Elbasan Z. Ardian Turku,Perfaqesuse nga Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe administrimit te ujrave Z. Gjon Fierza , Bordi i Shoqates Rajonale te Pyjeve dhe Kullotave Komunale Qarku Elbasan (SHRPKK QE ), Kryetare Shoqatash, Kryetare Komunash nga i gjitha Qarku , perfaqesues nga Drejtorite e Sherbimit

*Pyjore ne kater rrethet e Qarkut , Ambientalist , Specialiste Pyjesh , perfaqesue nga SHKPKK , perfaqesues nga federatat e Pyjeve ne Qarqet Tirane ,Diber , Korce ,Kukes gazetare, perfaqesues nga SNV Tirane Z. Jani Malaj etj.*

**Takimin e hapi Z. Ndricim Çela Kryetare i SHRPKK QE i cili pershendet takimin dhe falenderon pjesemarrësit si dhe ne vecanti Kryetarin e Keshillit Qarkut Elbasan Z. Ardian Turku ku te cilen i jep dhe fljalen pershendentese .**

**Kryetari Keshillit te Qarkut Elbasan Z. A.Turku falenderoi te gjithë pjesemarrësit dhe vazhdoi me diskutimin e tij dhe nder te gjitha ai theksoi :- Natyrisht nje reforme e tille dhe e thelle ne pronesine mbi pasurite pyjore kerkon shume me teper pergjegjshmeri nga ana e drejtuesve te Njesive te Qeverisjes Vendore per ti mbrojtur, zhvilluar, menaxhuar e shfrytezuar me**



**sukses keto resurse qe i vihen ne dispozicion te komunitetit qe sejcili drejton. Ne keto drejtim kerkohet qe nga ana e drejtuesve te Komunave te mbeshteten e vleresohen me drejt Shoqatat e Pyjeve dhe Kullotat Komunale si partneret me te vlefshem e te besueshem e te vetmet perfaqesuese te komunitetit -Nder te tjera Kryetari Keshllit Qarkut thekson se:**

**Nga problemet e dala ne keto takime e ne vazhdimesi mendojme te vecojme te terheqim vemendjen ne keto ceshtje:**

- 1 Me shume angazhim e seriozitet per marrjen e pergjegjesive dhe detyrimeve nga drejtuesit per nje menaxhim te qendrueshem e afatgjate te pasurive pyjore qe ju vihen ne dispozicion per te miren e komunitetit,ne zbatim te ligjeshmerise.**
- 2 Me shume perpjekje per ngritjen e shkalles se ndergjegjesimit dhe sensibilitetit te komunitetit lokal per pjesmarrje aktive ne punen me pasurite pyjore.**
- 3 Me shume kujdes e bashkpunim me te frutshem me SNV per ngritjen e kapaciteteve drejtuese te Shoqatave te Pyjeve Komunal per te siguruar nje zhvillim te qendrueshem ne te gjithë teritorin.**
- 4 Bashkepunim e komunikim me i ngushte e transparent i NJQV-ve - SHPKK-ve me strukturat teknike e profesionale te DSHP-ve(Drejtorite e Sherbimit Pyjor)**
- 5 Perfshirje ne strukturen organizative te Shoqates se Pyjeve e te Njesive te Qeverisjes Vendore qe kane se paku mbi 2000 ha pyje te nje specialisti te pyjeve e kullotave per mireadministrim e menaxhim te qendrueshem te burimeve natyrore ne teresi.....**
- 6 Njohje e zbatim te perpikte i ligjeshmerise per pyjet e kullotat nga te gjithë palet dhe te interesuarit .**

**Pas kesaj pershendetje takimi vazhdoi me rritesit e kapaciteteve ne Qarkun e Elbasanit**

**Z. Fatmir BRAZHDA** nje kohesisht dhe Sekretar i SHRPKK QE si dhe rritesit e kapaciteteve ne SNV Manjola SALLA dhe Ing. Abdulla DIKU te cilet shpjeguan para auditorit si dhe theksuan rendesine e transferimit te pyjeve dhe kullotave prane Njesive vendore dhe problemet e administrimit , te dhena mbi siperfaqet e transferuar ne Njesite vendore te Qarkurt Elbasan.

*Pas nje pushim Z. Ndririm Çela kryetari SHRPKK QE permbloodhi ne nje refart me vete te gjitha problemet qe kane dale gjate transferimit te pyjeve dhe kullotave ne Qarkun e Elbasanit ai theksoi domosdoshmerin nxjerrjen e nje ligji Per pyjet dhe kullotat per te mos u bazuar me ne VKM por ne ligje te vecante mbi pyjet : Shteterore , Komunale dhe Privat , forma e menaxhimit te tyre ne ligje dhe udhezime duke marre parasysh edhe sugjerimet qe vijne nga grupet e inetersit sic jane Njesite vendore , shoqatat , privatet etj.*

*Gjithashtu ky proces duhet te jete transparent dhe jo i njeanshem , te mos e shohim njeri tjetrin si armiq por te bashkepunojme ngushte per mireadmnistrin te qendrueshem te Resurseve Pyjore duke perkuar edhe me implementimin e Programeve dhe Politikave si dhe Strategjise te Zhvillimit Kombetare si nje proces qe i nevojitet Shqiperise per te gene pjese e strukturave Europiane dhe nderkombetare .*

**Perfqasuesi i MMPAU Z. Gjon Fierza** ne fjalen e tij nderhyri ne disa momente dhe thekson se ne po evidentojme te gjitha problemet dhe jemi te gatshem per te diskutuar dhe per te bashkepunuar ne zgjedhjen e tyre- Ai theksoi se ky proces nuk eshte quajtur i perfunduar , te gjitha ato NJ.V qe kane probleme ne lidhje me transferimin mund ti evidentojne ato dhe mund ti paraqesin ato ne MMPAU dhe me tej ne KM per ndryshim te vendimit ( VKM).



**Pas te gjitha referatave te mbajtura takimi vazhdoi me rendin e dites e cila ishte pjese e diskutimeve , pyjetjeve dhe debateve , pjesemarrjesit kryesisht Kryetare Komunash dhe Kryetare Shoqatash i drejtuna mjaft pyetje perf. MMPAU probleme kryesisht mbi kufijte dhe siperfaqet e transferuar ne Komunat e tyre , - edhe njehere Z. Gj.Fierza duke pershendetur per interesin qe ato kishin per kete ceshtje i siguroi atyre se**

**MMPAU i ka ndjekur dhe do ti ndjeke me seriozitet te gjithe procesin e transferimit , gjithashtu sic theksom edhe me pare te gjitha problemet e dala ato duhen bere evident qe se bashku mund ti zgjedhim sa me shpejt , po ashtu ne fjalen e tij ai u kerkoi NJV qe te ndejne me shume pergjegjesi per Menaxhimin e Pyjeve dhe**

**Kullotave Komunale duke mbrojtura dhe duke zbatuar rekomandimet e Planit te Menaxhimit .**

**Ing. Jani MALAJ ne fjalen e tij pershendetse ju kerkoi pjesmarresve kryesisht atyr qe kane probleme me trasferimin - qe ti vejne preznet ne SHRPKK QE me te gjitha dokumnetat qe disponoje dhe SHRPKK Qe ti ndjeke keto probleme deri ne zgjidhjen e tyre .,**

**Takimin e peshendeti edhe Rexhep Ndreu Kryetar i Fedrates Pyjeve dhe Kullotave Diber i cili falenderoi SHRPKK QE per insiativen dhe perkushtimin ne lidhje me takimin ai kerkon nje bashkepunim me te gjitha federatat e tjera per impenjeimin per te nxjerre ne pah te gjithe problemet dhe pe r ti ndjekur deri ne zgjidhje te tyre .**

**Ne fund SHRPKK QE doli me konkluzionet perkatese te cilat jane :**

- 1. Permiresimi dhe refoma e ligjit mbi Pyjet dhe Kullotat Komunale .**
- 2. Rishikimi i Problemeve te trasferimit per siperfaqet , kufijte midis fshatrave , Komune -DSHP , Komune – Komune dhe Rreth me Rreth .**
- 3. Vazhdimi i nje projekti tjeter i cili duhet te kete si objektiv – evidentimin e te gjitha perdoruesve real te Pyjeve dhe kullotave komunale duke perdorur rilevimet topografike si dhe pajisja e perdoruesve apo pronareve me nje dokument nga ZRPP.**
- 4. Ndryshimi i ligjit per SHPPKK per te mos u neshtruar nga taksat njesoj si bizneset fitim pruerese.**
- 5. Perfshirja ne NJ.V me ligj te nje specialisti Pyjesh ku te mbuloje nje siperfaqe jo me shume se 2000 ha siperfaqe pyjore .**
- 6. Mbeshtetja e Qeverise me projekte dhe fonde ndaj Shoqatave te pyjeve , si ato Rajonale ashtu edhe ato vendore si aktore kyc dhe perfaqesues direkt te kesaj ekonomie te rendesishme kombetare .**
- 7. Bashkepunim sa me i ngushte midis aktoreve DSHP-NJ.V- SHPPKK per te menaxhuar ne menyre te qendrueshme te gjitha Burimet Natyrore etj.**

**Pregatiti :**

**Ing. Fatmir BRAZHDA**